



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E KATEGORIVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS FIZIKË
2022**

1. HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së fizikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së fizikës në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit, si dhe të gjitha Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar sipas kërkesave të MAS-it për kualifikimin e mësuesve dhe përmban këto fusha kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve:

- dokumentet zyrtare¹, të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësimitdhënie – nxënies;
- programet përkatëse lëndore;
- aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimitdhënie-nxënie;
- aspekte të etikës dhe të komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtja shkencore e lëndës së fizikës sipas programeve lëndore përkatëse të AMU-së dhe AML-së.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

¹ Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- të ofrojë një program orientues për t'iu ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së fizikës në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DRAP-eve dhe ZVAP-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt, programi mund të plotësohet nga DRAP-et dhe ZVAP-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Nëpërmjet programit të kualifikimit, mësuesi përgatitet për testim. Ai:

- njeh dhe zbaton legjislacionin arsimor dhe rrisë më të fundit të reformës arsimore;
- zotëron kompetencat, bazuar në standardet profesionale të mësuesit, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- demonstroi aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e metodave për menaxhimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të reja të vlerësimit të nxënësve etj.;
- tregon përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe në zbatimin e tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe veçoritë e klasave ku japin mësim;
- njeh konceptin e gjithëpërfshirjes dhe demonstroi përfshirjen e nxënësve në procesin mësimor dhe në aktivitetet e shkollës;
- demonstroi zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- zotëron zbatimin e rregullave drejtshkrimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie –nxënies;
- përdori aftësitë e TIK-ut, për të rritur cilësinë e mësimdhënies-nxënies.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë/lëndë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;

– literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës/lëndës.

Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë/lëndë të testimit, do ta ndihmojë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	
FUSHA: DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor”	
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i fizikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe Rregulloren për funksionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. • zbaton legjislacionin, udhëzimet e MASR dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. • Rregullore e funksionimit të institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhër nr.31, datë 28.01.2020 • Udhëzuesi nr. 17 “Për fillimin e vitit shkollor 2021-2022 në sistemin arsimor parauniversitar”, MAS (16.08.2021). • Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar” i ndryshuar me Udhëzimin nr.14, datë 28.07.2021. • Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” • Udhëzimi nr.4, datë 26.2.2021 “Për

<ul style="list-style-type: none"> • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<p>kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë” • Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë” • Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë” • Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”
--	--

FUSHA: PROGRAME LËNDORE TË FIZIKËS

Kompetenca “Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të fizikës në shkollë”	Literatura e rekomanduar
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i fizikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit ku zhvillohet mësimi; • zbërthen me fleksibilitet programin lëndor në përshtatje me kërkesat bashkëkohore për zbatimin e tij; • harton materiale plotësuese kurrikulare për tema të veçanta në shërbim të përvetësimit të koncepteve dhe aftësive që 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza Kurrikulare, 2014 • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014 • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016 • Programet e fizikës sipas kurrikulës së re bazuar në kompetenca, për klasat (VI-IX) të AMU-së dhe klasat (X-XII) të AML-së

<p>kërkon programi kur e shikon të arsyeshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> • harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton rezultatet e të nxënit për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me njohuritë dhe shkathtësitë e programit; • kategorizon rezultate të të nxënit të programit sipas dokumentit të niveleve të arritjes së të nxënit; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të fizikës); • shpjegon lidhjen program-tekst; • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të realizuar përmbushjen e objektivave të programit; • siguron informacione që demonstrojnë lidhjen e fizikës me lëndët brenda fushës së shkencave të natyrës, si dhe me lëndët e fushave të tjera dhe situata të jetës reale. 	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË DHE TË METODOLOGJISË NË MËSIMDHËNIE/NXËNIE

<p>Kompetenca I</p> <p>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e fizikës”</p>	<p>Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i fizikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015 • Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës me

<p>përgjegjësi gjatë punës së tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshtat metodat e zgjedhura me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet në komunikimin me nxënësit; • identifikon nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikon plane afatshkurtra dhe afatgjata për punën me nxënësit me nevoja të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe kryesisht lëndës së fizikës; • edukon të nxënësit një dashuri për lëndën e fizikës; • motivon nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • krijon një klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për të gjithë nxënësit; • bashkëpunon me prindërit për të arritur progresin e nxënësve pavarësisht veçorive specifike të tyre. 	<p>kompetenca në AMU, IZHA, 2017</p> <ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca në gjimnaz, IZHA, 2016 • Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018 • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së fizikës në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018 • Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së fizikës në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018
<p align="center">Kompetenca II “Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e fizikës”</p>	<p align="center">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i fizikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh metodat dhe teknikat e 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca në AMU, IZHA 2017 • Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës me

<p>përshatshme për arritjen e një objektivi të caktuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur , kritik dhe krijues të nxënësve; • shpjegon strategjitë dhe metodologjitë bazë të mësimdhënies së fizikës si : <ul style="list-style-type: none"> - problem-zgjidhja; - eksperimenti fizik; - hulumtimi; - puna në grup; - të mësuarit multimedial; - të mësuarit me projekte; - përdorimi i TIK-ut; - etj. • skicon hartën e koncepteve të një blloku tematik; • përshkruan të paktën dy metoda të nxitjes dhe stimulimit të nxënësve; • strukturon një ese në fizikë; • përshkruan hapat që ndjek për përshtatjen e tekstit me planifikimin lëndor të programit; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • planifikon një orë mësimore, duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • shpjegon parimet e hartimit të një testi; • planifikon mjetet e nevojshme për një orë mësimi; • zbaton strategji të ndryshme të vlerësimit; 	<p>kompetenca në gjimnaz, IZHA 2016</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nivelet e arritjes së kompetencave – Shkalla e tretë dhe e katërt, klasat VI-IX, IZHA 2016 • Nivelet e arritjes së kompetencave – Shkalla e pestë, klasat X-XI, IZHA 2016 • Nivelet e arritjeve të kompetencave - Shkalla e gjashtë, klasa XII, ASCAP, 2019 • Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018 • Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019 • Udhëzues kurrikular lëndor për fizikën (Material ndihmës për mësuesit e fizikës në arsimin e mesëm të ulët), klasat (6-9), IZHA, 2018 • Udhëzues kurrikular lëndor për fizikën (Material ndihmës për mësuesit e fizikës në arsimin e mesëm të lartë), klasat (10-12), IZHA, 2018 • Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), Lënda “Fizikë”, ASCAP, 2019 • Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, (pjesa për testet e fizikës)
--	---

<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon vlerësimin e vazhdueshëm, vlerësimin me test/detyrë përmbledhëse dhe vlerësimin e portofolit/dosjes; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit. 	
<p style="text-align: center;">Kompetenca III</p> <p>“Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies - nxënies në lëndën e fizikës”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i fizikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton tema mësimore nga lënda e fizikës duke përdorur programe të përshtatshme si: Word, Power-Point, Excel, Math Type, Internet; • nxiti nxënësit të bëjnë prezantime në lëndën e fizikës për tema të veçanta, duke përdorur programe kompjuterike të njohura nga kurrikula e TIK-ut në shkollë; • përdori materiale të gjetura nga Web-et në internet për të lehtësuar procesin e mësimdhënie-nxënien; • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare ku njohuritë e marra nga lënda e fizikës ndërthuren me njohuritë e lëndëve të fushës së shkencave të natyrës, si dhe me lëndët e fushave të tjera kurrikulare. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tekste apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së fizikës, që përdoren në klasat VI-IX të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X-XII të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie - nxënie. • Udhëzues kurrikular lëndor për fizikën (Material ndihmës për mësuesit e fizikës në arsimin e mesëm të ulët), klasat (6-9), IZHA, 2018 (pjesa e metodës së simulimeve dhe appleteve) • Udhëzues kurrikular lëndor për fizikën (Material ndihmës për mësuesit e fizikës në arsimin e mesëm të lartë), klasat (10-12), IZHA, 2018 (pjesa e metodës së simulimeve dhe appleteve) • Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021.

	<ul style="list-style-type: none"> Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP, 2021.
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT	
“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme për të gjithë veprimtarinë e mësuesit”	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i fizikës:</i> <ul style="list-style-type: none"> zotëron rregullat e etikës dhe komunikimit që duhen zbatuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të komunikimit në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE	
“Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe “	Literatura e rekomanduar
Rezultatet e pritshme <i>Mësuesi i fizikës:</i> <ul style="list-style-type: none"> zotëron rregullat e drejtshkrimit të 	<ul style="list-style-type: none"> Drejtshkrimi i gjuhës shqipe

<p>standardit të gjuhës shqipe;</p> <ul style="list-style-type: none"> demonstron zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS	
<p style="text-align: center;">Kompetenca</p> <p>“Zotërimi i kompetencave shkencore për mësimdhënien e lëndës së fizikës”</p>	<p style="text-align: center;">Literatura e rekomanduar</p>
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i fizikës</i></p> <ul style="list-style-type: none"> shpjegon <i>konceptet bazë, parimet dhe ligjet e fizikës</i> që përmban programi i klasave (6-9) të arsimit bazë (AMU) dhe i klasave (10-12) të gjimnazit (AML) dhe shkollave profesionale; interpretin <i>konceptet bazë, parimet dhe ligjet e fizikës</i> nëpërmjet konkretizimit me shembuj; përshkruan koherencën vertikale të koncepteve dhe shprehive nga njëra klasë në tjetrën; dallon ndërvarësinë e <i>koncepteve, parimeve dhe ligjeve të fizikës</i> me konceptet e lëndëve të tjera; përdor metoda të ndryshme për zgjidhjen e situatave problemore në lëndën e fizikës duke përdorur konceptet, parimet dhe ligjet fizike; mbledh informacion të saktë e bindës nga burime të besueshme për t’u treguar nxënësve ndikimin e lëndës së fizikës në lëndët e tjera si dhe zbatimet e ligjeve të fizikës në veprimtarinë e jetës së përditshme. 	<ul style="list-style-type: none"> Programe dhe tekste shkollore të lëndës së fizikës për mësuesin dhe nxënësin për klasat (VI-IX) AMU dhe për klasat (X-XII) AML Tekste me ushtrime dhe problema për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të fizikës në Maturën Shtetërore dhe Olimpiadat kombëtare